

AKTI
I
THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BETA CONSULTING” SH.P.K.

Sot më datë 23/02/2021 une e nënshkruara:

Znj.**Eriselda Brahushaj** e datëlindjes 09.04.1992, lindur në Ballesh dhe banuese në Tiranë,

shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë **“BETA CONSULTING” Shpk** si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria **“BETA CONSULTING” Shpk**, nga këtu më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e **“Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar”** shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Ortaku themelues i shoqërisë është :

Znj.**Eriselda Brahushaj** zotëron 100 % të kapitalit themeltar.


3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë **“BETA CONSULTING” sh.p.k.** do të jetë:

Kryerja e shërbimeve të konsulencës në fushën e teknologjisë së informacionit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Të organizojë trajnime, të importojë dhe të eksportojë mallra dhe shërbime dhe çdo veprimtari në lidhje me fushën e teknologjisë së informacionit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kryej çdo aktivitet ekonomik që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm, në mënyrë që të përmbushet qëllimi i veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë **“BETA CONSULTING” sh.p.k.** do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga Spiro Comora, ndërtesa Nr.8/6, Njësia Administrative Kashar, Zona Kadastrale Nr. 3866. Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.



5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë 1 (një) vjeçare, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të ortakut, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **“BETA CONSULTING” sh.p.k.** është 100 (njëqind) lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë të Përgjithëshme të Ortakëve. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të Shoqërisë në të gjitha bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Ortakët e shoqërisë

Ortaku i Shoqërisë ushtron kopetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakëve

8. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë **“BETA CONSULTING” sh.p.k** është Znj. **Eriselda Brahushaj**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme të Ortakëve, për një periudhë 1 vjeçare.

Përfaqësimi i Shoqërisë tregtare **“BETA CONSULTING” sh.p.k** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njuh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësoj Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

9. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

THEMELUESI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BETA CONSULTING” SH.P.K

Eriselda BRAHUSHAJ
